



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**LEGJISLATURA VI**

*Sesioni pranveror*

**Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor**

Mbledhja nr. 14

Prishtinë, më 27.3.2018, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

**PROCESVERBAL**

Në mbledhje morën pjesë: Daut Haradinaj, Besa Gaxherri, Driton Çausi, Lutfi Zharku, Andin Hoti, Danush Ademi, Ganimete Musliu, Enver Hoti, Salih Salihu.

Munguan : Sërgjan Mitroviq, Liburn Aliu.

Stafi mbështetës i Komisionit: Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi, **Daut Haradinaj**, kryetar i Komisionit.

**Rendi i ditës:**

**1. Shqyrtimi i projektligjit për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguri nukleare,**

**Kryetari Daut Haradinaj** falënderoi grupin punues për punën e kryer dhe para se të procedohen amendamentet **Enver Hoti** pyeti për amendamentet e parashtruara nga Teuta Haxhiu të cilat sipas kryetarit kanë qenë të jashtëafatshme por ai personalisht i përkrahu.

Komisioni vendosi që Amendamentet nga deputetja Teuta Haxhiu të procedohen por pa përkrahjen e komisionit. **Driton Çausi** potencoi se këto amendamente nga Teuta Haxhiu grupi punues nuk ka pasur kohë ti procedoi dhe njoftoi se sipas sugjerimit të kryeshefit të agjencisë Beqir Mezelgjiut ato kanë qenë josubstanciale për këtë ligj. Kryetari ftoi komisionin që të procedohet projektligji për leximin e dytë me këto amendamente :

**Amendamenti 1**

**Neni 1**, paragrafi 1 riformulohet si vijon:

**Qëllimi i këtij Ligji është të mbrojtë shëndetin e individëve që i nënshtrohen ekspozimit profesional, mjekësor, publik dhe mjedisin nga efektet e dëmshme të rrezatimit jonizues dhe jojonizues, të sigurojë nivel të lartë të sigurisë bërthamore dhe të përmbushë detyrimet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës në këtë fushë.**

**Amendamenti 2**

**Neni 2**, riformulohet si vijon:

**1. Ky ligj zbatohet për të gjitha aktivitetet dhe praktikat që përfshijnë përdorimin paqësor të energjisë bërthamore dhe rrezatimit jonizues të kryer në territorin ose nën juridiksionin ose kontrollin e Republikës së Kosovës.**

**2. Ky Ligj zbatohet për çdo situatë ekspozimi të planifikuar, ekzistuese ose emergjente që përfshin një rrezik nga ekspozimi ndaj rrezatimit të cilat nuk mund të mos merren parasysh nga pikëpamja e mbrojtjes nga rrezatimi ose në lidhje me mjedisin, në funksion të mbrojtjes afatgjatë të shëndetit të njeriut.**

**3. Ky Ligj përcakton statusin, detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë së Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe për Siguri Bërthamore, përgjegjësinë për të komunikuar me shtetet tjera dhe organizatat ndërkombëtare relevante dhe përgjegjësitë për të arritur objektivat e përcaktuara në këtë Ligj.**

### **Amendamenti 3**

**Neni 4, në fillim shtohet një nënparagraf i ri “Agjencia- Agjencia e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe për Siguri Bërthamore”**

### **Amendamenti 4**

**Neni 5 paragrafi 2, pas fjalës “ekonomik” shtohet fjala “teknik” dhe vazhdon teksti si në projektligj.**

### **Amendamenti 5**

**Neni 6, riformulohet si vijon:**

**1. Agjencia e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe për Siguri Bërthamore është Agjenci Ekzekutive (në tekstin e mëtejme Agjencia) e cila vepron në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.**

**2. Agjencia është e ndarë për nga funksionimi prej çfarëdo trupi ose organizate tjetër e cila merret me promovimin ose përdorimin e praktikave të rrezatimit ose përdorimit të energjisë bërthamore sipas këtij Ligji.**

**3. Agjencia për të siguruar pavarësi efektive ndaj ndikimeve të paligjshme në funksionimin e saj si rregullator i janë dhënë kompetenca ligjore, si dhe burime njerëzore dhe financiare, të nevojshme për të përmbushur detyrimet e saj.**

### **Amendamenti 6**

**Neni 7, paragrafi 1, pas fjalës “Agjencia” fshihetogfjalëshi“ndër të tjera”dhe vazhdon teksti si në projektligj.**

**Nën-Paragrafi 1.3, pas fjalës ” Lëshon” shtohet fjala “ndryshon” dhe vazhdon teksti.**

**Nën-Paragrafi 1.6, në fillim fshihet fjala “Agjencia”.**

**Nën-paragrafi 1.8. pas fjalës “dozave” pjesa tjetër riformulohet “së ekspozimit të punonjësve”.**

### **Amendamenti 7**

**Neni 10 , Nën-paragrafi 1.1.fshihet pjesa e dytë e fjalisë ”dhe ekspozim emergjent në punë”**

### **Amendamenti 8**

**Neni 19, paragrafi 1, riformulohet si vijon:**

**Ndërmarrja duhet të ofrojë edukim, trajnim dhe informacion të duhur për mbrojtjen nga rrezatimi, veçanërisht për pajisje, për të gjithë individët detyrat e të cilëve kërkojnë kompetenca specifike ne mbrojtje nga rrezatimi, veçanërisht në:”**

### **Amendamenti 9**

**Neni 20**, Nënparagrafi 2.11, riformulohet si vijon: **“Vlerësimin e dozës së ekspozimit të punonjësve:**

### **Amendamenti 10**

**Neni 21**, në fund të paragrafit 3 shtohet: **“sipas legjislacionit në fuqi”**

### **Amendamenti 11**

**Neni 24**, paragrafi 3 pas fjalës **“fqinje”** t lidhësja **“dhe”** zëvendësohet me **“,”** dhe vazhdon teksti.

### **Amendamenti 12**

**Neni 27**, në titullin e nenit fjala **“Hapësirat”** zëvendësohet me **“Zonat”**

### **Amendamenti 13**

**Neni 28**, Paragrafi 3, korigjohet referenca **“paragrafin 3”** në **“paragrafin 2”**

### **Amendamenti 14**

**Neni 29**, paragrafi 2.3, riformulohet si vijon:

**2.3.Mbetjet radioaktive do të depozitohen në Republikën e Kosovës, përveç nëse në kohën e dërgimit ka një marrëveshje e cila ka hyrë në fuqi ndërmjet shtetit anëtar përkatës dhe një Shteti tjetër Anëtar ose një vendi të tretë për të përdorur një objekt të depozitimit në njërin prej tyre.**

### **Amendamenti 15**

**Neni 45**, në fund të paragrafit 1, fshihet fjala **“mundet”** .

### **Amendamenti 16**

Emërtimi i kapitullit **IX**, **“SANKSIONET”** zëvendësohet me **“DISPOZITAT NDËSHKUESE”**

### **Amendamenti 17**

**Neni 47**, Nën-paragrafi 3.7.11, riformulohet si vijon: **“Vlerësimin e dozës së ekspozuar të punonjësve”**

### **Amendamenti 18**

Riformulohet titulli i kapitullit X, si vijon:

**“KAPITULLI X- DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE”**

## **2. Të ndryshme**

Sipas propozimit të deputetes **Besa Gaxherri**, komisioni vendosi që të mbahet mbledhja e komisionit nesër më 28 mars 2018 në orën 13,00 për kualitetin e mishit dhe prodhimeve nga ai, ngase shtrohet pyetja e kompetencës së këtij komisioni për të dhënë mendimin për këtë çështje të rëndësishme. Gjithashtu Besa Gaxherri propozoi që të shqyrtohen dhe analizohen marrëveshjet me Serbinë të cilat i përkasin fushës së këtij komisioni.

E përgatiti:

**Stafi mbështetës i Komisionit.**

Kryetari i komisionit,

**Daut Haradinaj**